

Vendim nr. 126 datë 05.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 05.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (G) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **GENC DRITA dhe HAXHI SALLAKU**, përfaqësuar nga avokat Kastriot Selita, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-516 (113), datë 21.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 17, 41, pika 5, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 13.06.2013 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan” (VKM nr. 545/2013), ndër të tjerë, janë shpronësuar edhe kërkuesit Genc Drita dhe Haxhi Sallaku (*kërkuesit*), i pari përkundrejt vlerës 5 529 909,6 lekë për pasurinë banesë 1 kat dhe truall me sipërfaqe 2388 m², të ndodhur në fshatin Ibë, Tiranë, ndërsa i dyti përkundrejt vlerës 2 088 089,6 lekë për pasurinë truall me sipërfaqe 1088 m², të ndodhur në fshatin Bërzhitë, Tiranë.

2. Në datën 17.09.2013 kërkuesit kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatë kundër Këshillit të Ministrave (KM), Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), në të cilën kanë kërkuar anulimin e pjesshëm të VKM-së nr. 545/2013 në lidhje me masën e vlerës së shpronësimit dhe shpërblimin e tyre sipas vlerës reale të pasurive të shpronësuar.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2294, datë 18.02.2014, ka shpallur moskompetencën lëndore, duke ia dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 4319, datë 22.07.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së kërkuesve, shfuqizimin e pjesshëm të VKM-së nr. 545/2013 (pikave 13 e 14) dhe ndryshimin e vlerave të shpronësimit të pasurive të tyre, si dhe detyrimin e KM-së dhe MTI-së për shpërblimin e diferencës së vlerës së shpronësimit për kërkuesin Genc Drita në masën 14 616 910 lekë dhe për kërkuesin Haxhi Sallaku në masën 6 615 910 lekë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit mbi të cilat, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 521 datë 14.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë.

4. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit. Fillimisht, me vendimin nr. 256, datë 24.05.2017, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e kërkesës së MTI-së për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit deri në përfundimin e shqyrtimit të rekursit. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-516 (113), datë 21.03.2022, pasi ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë së kërkuesve, me arsyetimin se ajo ishte parashkruar, ndërsa ishte paraqitur në gjykatë jashtë afatit ligjor 30-ditor.

5. Në datën 22.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e pronës, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuesve për masën e shpërblimit të shpronësimit edhe pse ata e kanë paraqitur padinë në gjykatë brenda afatit ligjor 30-ditor nga marrja dijani e VKM-së nr. 545/2013. Në lidhje me njoftimin dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë, Gjykata e Lartë e ka vënë theksin në njoftimin e VKM-së së shpronësimit nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare, çka nuk është në përputhje me jurisprudencën kushtetuese sipas vendimeve nr. 22, datë 25.04.2023, nr. 40, datë 22.12.2022 dhe nr. 29, datë 01.11.2021 të Gjykatës. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim me nismën e vetë dhe për herë të parë çështjen e afatit të ngritjes së padisë, për të cilën palët nuk kanë pasur pretendime dhe ajo nuk ka qenë asnjëherë objekt i debatit gjyqësor në gjykatat më të ulëta. Në kushtet kur ka vënë në diskutim kryesisht një çështje të ligjit që nuk është ngritur as në rekurs, Gjykata e Lartë ka vepruar në shkelje të nenit 473/a, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ndërkohë që në respektim të nenit 482, paragrafi 1, shkronja “b”, të këtij kodi, ajo duhet të dëgjonte paraprakisht palët, goftë edhe me shkrim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret e lartpërmendura për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kolegji vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin është marrë vendimi objekt kundërshtimi, për rrjedhojë janë bartës të të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, duke pasur interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

10. Kërkuesit plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ata nuk kanë mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç kërkesës në këtë Gjykatë.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr.8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, fillimisht, Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Më pas, në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) dhe qëndrimit të saj në çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. kundër Shqipërisë (*shih vendimin e datës 09.05.2023 mbi aplikimin nr. 20702/18*), në drejtim të përcaktimit të momentit nga i cili fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor, Gjykata ka vlerësuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si datë e

marrjes dijëni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar i saj bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 21.03.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 22.04.2024 (*data e dorëzimit në shërbimin postar*), pra në dukje jashtë afatit ligjor. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuesit në ankimin e tyre kanë parashtruar se për një periudhë 5-vjeçare nga paraqitja e rekursit ata nuk kanë pasur asnjë dijëni kur do të shqyrtohej çështja nga Gjykata e Lartë dhe nuk kanë pasur asnjë njoftim paraprak për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit të datës 21.03.2022. Po ashtu, sipas tyre, ata nuk janë njoftuar për vendimin e kësaj të fundit qoftë në rrugë postare, qoftë në rrugë elektronike, ndërsa për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë kanë marrë dijëni vetëm pasi përfaqësuesi i tyre është interesuar pranë sekretarisë gjyqësore, ku pas kërkesës me shkrim të tij, Gjykata e Lartë i ka dërguar kopje të vendimit me shkresën nr. 1256/1 prot., datë 15.03.2024, që i është dorëzuar atij në datën 20.03.2024. Sipas kërkuesve, kjo e fundit është data e marrjes dijëni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë, ku referuar kësaj date ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, në çështjen “*Supergrav Albania*” *sh.p.k. kundër Shqipërisë*.

13. Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se përmes njoftimit publik të datës 18.02.2022 ajo gjykatë ka njoftuar për shqyrtimin e çështjes së kërkuesve nga Kolegji Administrativ i saj në dhomën e këshillimit të datës 21.03.2022. Ndërkohë, nga komunikimi elektronik i datës 14.05.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 28.04.2023, datë në të cilën ai është bërë i disponueshëm për palët.

14. Për sa më sipër, nën dritën e rrethanave të rastit konkret dhe duke pasur parasysh standardet e vendosura në lidhje me momentin e marrjes dijëni të vendimit që përbën mjetin e fundit ankimor, Kolegji konstaton se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 28.04.2023, e cila përbën edhe datën e fillimit të afatit ligjor të ankimit kushtetues individual, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në datën 22.04.2024, domethënë pas gati 12 muajsh, pra në kapërcim të afatit ligjor 4-mujor.

15. Kolegji vëren se kërkuesit kanë pasur dijeni për procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, ndërsa pranojnë dijeninë për rekursin e palës kundërshtare, përveçse kur ajo gjykatë më herët ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit të dhënë në favorin e tyre. Ndërkohë rezulton se Gjykata e Lartë ka proceduar rregullisht sipas ligjit me njoftimin publik të palëve për shqyrtimin e çështjes nga ana e saj në dhomën e këshillimit të datës 21.03.2022. Nga ana tjetër, pavarësisht pretendimit për mungesën e një njoftimi në adresën elektronike, Kolegji vëren se kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë provë nëse ata dhe/ose përfaqësuesi i tyre të kenë deklaruar të dhënat elektronike të kontakteve me qëllim dërgimin e njoftimeve edhe në rrugë elektronike. Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk kanë paraqitur argumente ose prova për vërtetimin e pamundësisë për të marrë dijeni për vendimin objekt kundërshtimi të Gjykatës së Lartë edhe pasi ai është bërë i disponueshëm për palët, pra nga data 28.04.2023. Gjykata ka pohuar në vendimet e saj se është detyrë e palëve të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre pranë Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, pretendimi i kërkuesve se ata janë njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pasi përfaqësuesi i tyre është interesuar për të marrë informacion pranë saj, nuk mund të shërbejë për të provuar në nivel kushtetues se kjo është data e marrjes dijeni për vendimin objekt kundërshtimi, për sa kohë është në të drejtën e palës në proces për të kërkuar dhe tërhequr në çdo moment pranë sekretarisë së gjykatës kopje të vendimit gjyqësor.

16. Në këto kushte, Kolegji çmon se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues është paraqitur përtej afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

